




FONDET E BE-SË PËR MBËSHTJETJEN E ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË CIVILE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 2007-2013

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARA-ADERIMIT PËR SHOQËRINË CIVILE (IPA CSF): ANGAZHIMI I PLOTËSUAR PJESËRISHT


BE mbështet zhvillimin e shoqërisë civile dhe të mjedisit mundësues në të cilin shoqëria civile vepron në vendet e zgjerimit përmes Instrumentit të Ndhmës së Para-Aderimit për Shoqërinë Civile. Kur ky instrument u themelua në vitin 2008 angazhimi i Komisionit ishte alokimi i 2% të shumës së përgjithshme të fondeve IPA për këtë qëllim, në çdo vend. Gjatë periudhës 2007-2013, një total prej €136.6 milion (mesatarisht 1.2%) u planifikua për IPA CSF, nga i cili €60.8 milion (mesatarisht 1.6%) për programet kombëtare dhe €75.8 milion (mesatarisht 5.3%) për programet rajonale.

KE e tejkaloi angazhimin për të alokuar 2% të IPA për IPA CSF në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Mal të zi.

Në vendet tjera, mesatarisht, 1.2% e IPA u alokua, ose vetëm €2.85 për frymë për gjithë periudhën 7 vjeçare.



PËRTHITHJA E FONDEVE: PERFORMANCË E LARTË E SHC



Deri në fund të vitit 2014, nga IPA CSF 2007-2013 janë alokuar mesatarisht 71% nga programi rajonal dhe 91% nga programi kombëtar.

Nga ato që u alokuan, 93% e fondeve të programit rajonal të IPA CSF u paguan; dhe së paku në të njëjtën vlerë – 93% u paguan për çdo program kombëtar IPA CSF (me përjashtim të Maqedonisë¹).

MODELET DOMINUESË TË ASISTENCËS: GRANTET & ASISTENCA TEKNIKE

Në **nivel kombëtar** IPA CSF u përdor për grante të dhëna përmes thirrjeve publike – €40.8 milion dhe për asistencë teknike (AT) në mbështetje të institucioneve ose mekanizmave qeveritare për përforcimin e bashkëpunimit Qeveri - ShC dhe zhvillimit të ShC si dhe për menaxhimin e granteve – €10 milion. AT u shfrytëzua në 3 vende: Bosnje Hercegovinë (48% IPA CSF kombëtare), Maqedoni (35%) dhe Serbi (14%).

Në **nivel rajonal** IPA CSF u përdor për AT për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO) – €25 milion, për grantet nëpërmjet thirrjeve publike – €29.2 milion, grantet e drejtëpërdrejta² – €4.2 milion dhe programit “Nga njerëzit për njerëzit” (People 2 People)³ – €4 milion.



¹ Niveli i ulët i përthithjes në Maqedoni është rezultat: a) anulimi i një thirrje (136-000/L/ACT/MK) për shkak të vonësave në procesin e vlerësimit; b)

Informacione zyrtare jo të plota në lidhje me projektet e kontraktuara Cfp 134588/L/ACT/MK, mbyllur me 13.09.2013

² Grante të drejtëpërdrejta u janë akorduar UNICEF, BIRN, RECOM, European Broadcasting Union, and Media Circle.

³ Që nga 2012, programi People 2 People është pjesë përbërëse e TACSO.

GRANTET IPA CSF: MAKSIMIZIMI I FLEKSIBILITETIT TË BE-SË PËR TË PËRM-BUSHUR NEVOJAT E OSHC-VE LOKALE


Deri në fund të vitit 2014, në nivel kombëtar janë realizuar 32 thirrje publike në kuadër të së cilave janë financuar 337 projekte. Vlera e të cilave arrin shumën e €40.8 milion. Shuma mesatare e projekteve ishte €134,157, kohëzgjatja 18.5 muaj dhe niveli i bashkë-financimit të BE-së ishte 89.5%. Numri më i madh i projekteve lidhet me mbështetjen e shoqërisë civile, monitorimin dhe dialogun mbi politikat publike në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe projekte që trajtojnë probleme tematike siç janë korrupsioni, mjedisi, aftësitë e kufizuara dhe fëmijët.

Vendi	Nr i thirrjeve	Nr. i projekteve	Totali i alokimeve (me thirrje)	Totali i kontraktuar	% kontraktuar	Kostoja mes. e granteve	Kohëzgjatja mes.
Shqipëria	8	47	€6,640,000	€6,508,691	98.02	€109,146	21
B. Hercegovina	6	47	€7,870,000	€6,954,666	88.37	€151,425	19
Kosova	5	22	€5,600,000	€5,406,635	96.55	€195,889	24
Maqedonia	3	45	€4,325,000	€2,661,168	61.53	€103,212	15
Mali i Zi	5	41	€6,280,000	€5,995,849	95.48	€143,741	17
Serbia	5	135	€13,700,000	€13,353,633	97.47	€101,528	15
Total Nacionale	32	337	€44,415,000	€40,880,642	89.57	€134,157	18.5
Regjionale	9	91	€29,950,000	€30,898,194	103.17	€339,541	29

Në nivel rajonal u shpallën 9 thirrje publike dhe u akorduan 91 projekte. Çmimi mesatar i granteve ishte €339,541 me kohëzgjatje mesatare prej 29 muaj. Niveli i bashkë-financimit të BE-së është më i ulët se te projektet kombëtare, me një mesatare prej 78.8%.

Nëse krahasojmë gjetjet me analizën për zbatimin e IPA CSF deri më 2012 të realizuar nga BCSDN⁴, vërehet një trend pozitiv i orientimit të IPA CSF drejt mbështetjes së projekteve afatgjata me kosto më të lartë. Projektet e akorduara deri në vitin 2012 kishin një mesatare prej €106,011 me një kohëzgjatje prej 16 muaj, ndërsa projektet e akorduara në 2013-2014 kishin kosto mesatare prej €155,941 dhe një kohëzgjatje mesatare prej 20 muaj. Po ashtu, në 3 vitet e fundit shumica e thirrjeve për propozime, si dhe projektet e financuara, përfshijnë edhe komponentin për ri-grantim.

EFIÇENCA E INSTITUCIONEVE KONTRAKTUESE: DALLIME TË MËDHA



Koha që KE-së i nevojitet për vlerësimin dhe kontraktimin e projekteve varion nga 4.5 muaj në Shqipëri në 8.1 muaj në Mal të zi. Në Maqedoni, ku 1 nga 3 skemat e grantimit menaxhohet nga sistemi i decentralizuar (DIS), koha mesatare ishte 10.3 muaj.

KAPACITETET E OSHC LOKALE: GJINDEN MIRË NË KONKURRENCË TË LARTË

Nga 91 projektet me shumë përfitues, 46 janë udhëhequr nga OshC-të e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, ndërsa 45 nga organizatat prej vendeve të BE-së.

Kur kemi parasysh përvojën dhe kapacitetet e organizatave nga BE, ky fakt tregon se OshC-të në Ballkanin Perëndimor kanë kapacitete të menaxhojnë projekte të mëdha rajonale. Numri më i madh i organizatave të ShC që realizojnë këto projekte janë nga Serbia – 13, Kroacia – 12 dhe Maqedonia – 7.

Përthithja e lartë e IPA CSF dhe numri në shkallë të madhe i projekteve rajonale të udhëhequra nga OshC lokale nga Ballkani Perëndimor tregon se OshC-të e kanë kapacitetin e duhur për implementimin e modelve të ndryshme të asistencës.

⁴ Ky ishte një nga rekomandimet kyçe të BCSDN në Punëtorinë mbi përkrahjen e BE-së për ShC në vendet në zgjerim, të organizuar në Bruksel në shtator të 2013. Për më shumë lexo <http://goo.gl/RgjuEC>

BASHKËPUNIMI RAJONAL: TË DYSHUARIT E ZAKONSHËM DHE BEFASITË

Vendi	AL	BIH	HR	KS	MK	MNE	RS	TR
AL	69	35	28	34	42	31	39	28
BIH	35	67	47	37	46	45	62	28
HR	28	47	52	30	38	36	48	23
KS	34	37	30	48	40	32	41	26
MK	21	46	38	40	68	41	54	28
MNE	31	45	36	32	41	69	46	26
RS	39	62	48	41	54	46	74	30
TR	28	28	23	26	28	26	30	40

Frekuenca e partneritetit të OShC për vend

Partneriteti i OShC-ve në pjesëmarrjen e projekteve rajonale tregon se ekziston një bashkëpunim i mirë ndër-kufitar në sektorin civil. Sipas numrit të partneriteteve të OShC-ve nga vendet e ndryshme, vihet re se afërsitë historike, kombëtare apo kulturore nuk janë përcaktuesit e vetëm.

Nga 69 projekte në të cilat pjesëmarrëse ishin OShC-të e Shqipërisë, si partnerë me të shpeshtë paraqiten OShC-të nga Macedonia. Serbia dhe Bosnjë Hercegovina në pjesën më të madhe marrin pjesë bashkarisht si partnere në 62 projekte. Si partnerë të OShC-ve nga Kosova janë OShC-të nga Serbia dhe Maqedonia (bashkërisht kanë marrë pjesë në 41 dhe 40 projektet respektive nga 48 projekte në total).

PROGRAME TJERA TË RËNDËSISHME TË BE PËR FINANÇIMIN E OShC-VE: KOMONENTI PËR BASHKËPUNIM NDERKUFITAR I IPA-S

OShC-të janë përfitues të afërsisht 60% të projekteve të bashkëpunimit ndër-kufitar. Si rrjedhojë, është thelbësore që rregullat që aplikohen në projektet e bashkëpunimit ndër-kufitar të përpilohen në mënyrë të përshtatshme për të siguruar një programim dhe zbatim më eficient dhe për të rritur efektivitetin.


Analiza, e cila u realizua vetëm për gjysmën e programeve të bashkëpunimit ndër-kufitar të IPA, tregon se në 59% të projekteve (në 141 nga 237) së paku njëri nga partnerët ishte OShC.

Deri në fund të vitit 2014, të paktën €18.3 milion (ose 38.4%) janë akorduar për OShC.

Me vetëm gjysmën e programeve të Bashkëpunimit Bërkufitar të IPA të analizuar, shumica e fondeve të akorduara për OShC-të nga ky komponent i IPA është 45% e programit kombëtar IPA CFS. Këto të dhëna priten të dyfishohen, nëse analiza përfshin të gjitha programet për Bashkëpunim Ndërkufitar të IPA.

Përveç IPA CSF, OShC-të në Ballkanin Perëndimor përfitojnë financim nga BE përmes programeve të tjera, nga të cilat më të rëndësishme janë Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EDIHR) dhe komponentit IPA për Bashkëpunim Ndërkufitar (CBC).

Për shkak të mungesës së informacionit për pjesëmarrjen e OShC-ve në komponentin IPA për Bashkëpunimin Ndërkufitar, BCSDN ndërmorri një analizë të thelluar të programeve në kuadër të komponentit për Bashkëpunim Ndërkufitar të menxhuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin⁵ deri në vitin 2014.




⁵ Për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme, analiza është bërë vetëm për programet e bashkëpunimit ndër-kufitar mes vendeve jo-anëtare, të menaxhuara nga DG për Zgjerim. Programet e menaxhuara nga vendet anëtare dhe DG Rajonale nuk janë të përfshira. Ato janë: Shqipëri - Greqi; Kroaci - Slloveni; Kroaci - Hungari; Maqedoni - Bullgari; Maqedoni - Greqi; Serbi - Bullgari; Serbi - Romani; Serbi - Hungari, IPA CBC Adriatic.

KUSH JEP MË SHUMË MJETE PËR OSHC: UE APO SHTETI?

FINANCIMI SHTETËROR PËR OSHC: NJË ANGAZHIM I PAQARTË


Gjetja e shumës aktuale që shtetet e Ballkanit ndajnë për ShC nuk është gjë e lehtë, për atë shkak janë analizuar 3 shtete. Në Maqedoni, ku përkrahja është më e vogla, nuk është e qartë se sa nga këto mjete të parapara për ShC ju jepen organizatave kulturore, politike apo religjioze. Situata është e njëjtë edhe në Serbi, edhe pse ekziston një raport qeveritar vjetor i detajur mbi financimin shtetëror të ShC (i vetmi i këtij lloji në regjion). Në Mal të zi, ku transparenca e mjeteve të dhëna është e nivelit më të lartë, problem paraqitet fakti që nuk shpërndahen gjitha mjetet e parapara për ShC sipas Ligjit për lojrat e fatit (burim primar i financimit të ShC).

Financimi shtetëror i OShC⁶
(sipas të dhënave të disponueshme për publikun)



DREJTIMI I FINANCIMIT TË OSHC: MË SHUMË KUJDES SHTETIT

Financimi mesatar vjetorë që ju shpërndahen OShC, per capita:



Edhe pse UE është donatori jashtëm më i madh për OshC, në Ballkanin perëndimor, në aspekt të sasisë së mjeteve, është shteti ai që siguron burimet më të mëdha të mjeteve për financim të OshC. Ngel ky fakt edhe nëse mjeteve të IPA CFS të i shtohen mjetet nga EDIHR (si program i paraparë enkas për OshC si shfrytëzues të fundit).

Financimi shtetëror vjetor i OShC është pothuaj në një nivel si ai i BE-së në Maqedoni, është 1.5 herë më i madh në Mal të zi, dhe më shumë se 4 herë më i madh në Serbi.

Përderisa KE ka konstatuar se "Më shumë duhet bërë për të nxitur një mjedis mundësues për organizatat e shoqërisë civile"⁷ në vendet e zgjerimit, financimi shtetëror duhet të përkrahët më tepër në axhendat e tyre me qëllim zhvillimin e "organizatave të shoqërisë civile që theksojnë llogaridhënien politike dhe promovojnë një kuptim më të thellë të reformave të lidhura me procesin e aderimit"^{8,9}

Financimi shtetëror është një burim i rëndësishëm financimi për OShC-të po aq sa BE. Si rrjedhojë, ai duhet të jetë objekt interesi për aktorët kombëtarë dhe të BE-së që promovojnë OShC transparente dhe të përgjegjshme.

⁶ Fondet e parashikuara për OShC-të: Në Maqedoni dhe Serbi – fondet e parashikuara për OShC-të sipas Raporteve Financiare Vjetore në linjat buxhetore për transferim të OShC (përfshijnë klubet sportive, organizatat fetare, partitë politike); Në Mal të zi fondet që duhet shpërndarë OShC-ve sipas Ligjit për lojra të fatit, dhe fondeve nga vetëqeverisja lokale.

Fondet e shpërndara vetëm për OShC-të: Në Maqedoni – fondet e shpërndara vetëm OShC sipas Ligjit për shoqatat dhe fondacionet; në Serbi – fondet për OShC janë shpërndarë vetëm nëpërmjet thirrjeve publike, për bashkë-financim, sipas linjave buxhetore për mbrojtje sociale, subvencioneve për ndërmarrje publike jo-financuese, shërbime të specializuara dhe shërbime kontraktuale; në Mal të zi – faktikisht fondet për OShC-të shpërndahen sipas Ligjit për lojra të fatit dhe fondet nga vetëqeverisja lokale.

⁷ European Commission, Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-15, p.20, Brussels, 8.10.2014

⁸ Ibid;

⁹ Për më shumë lexoni analizën e BCSDN mbi qasjen e BE ndaj zhvillimit të ShC-ve në Strategjinë e (fundit) mbi zgjerimin 2014-2015:

<http://goo.gl/HGBgpP>